



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr.238, datë 24.10.2019**

**PËR  
VERIFIKIMIN E KUSHTEVE DHE KRITEREVE LIGJORE PËR REKRUTIMIN SI  
GJYQTARE TË KANDIDATES, ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 35 në lidhje me nenin 32 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimet e Këshillit nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” dhe nr. 103 datë 05.07.2019 “Për caktimin e relatorit për verifikimin e kushteve dhe kriterëve për secilin kandidat për gjyqtar të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019”, në propozimin e relatores pranë Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Të kualifikojë për emërim, kandidaten {...}, e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018 – 2019 dhe vijimin e procedurës së emërimit të saj si gjyqtare.
2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet kandidates.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**